



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 409/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa e subjektit politik AKR përkitazi me kërkesën për rinumërimin e fletëvotimeve në Vendvotimet (VV) në komunën e Klinës 0805C/03R; 0801C/08R; 0817C/01R, Vushtri 2702X/01R; 2702X/03R; 2713B/03R, Lipjan 1304E/01R; 1325E/01R, Prishtinë 1921E/05R; 1912E/03E; 1907E/02D, Ferizaj 2505D/02R dhe në komunën e Gjilanit 0407D/01R dhe **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet për vendvotimet e lartpërmendura dhe po ashtu *ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2014.*
- II. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e subjektit politik AKR përkitazi me kërkesën që të rinumërohen të gjitha vendvotimet në Kosovë, të anulohen të gjitha votat e ardhura me postë , si dhe që të hetohen votat e shpallura si të pavlefshme vetëm në ato vendvotime ku ka më shumë se 10 fletëvotime të pavlefshme.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 27.06.2014, nga subjektit politik AKR, ku pretendon se rezultati i shpallur nga KQZ-ja nuk është në përputhje me vullnetin e shprehur nga ana e votuesve. Subjekti politik AKR ankesën e tyre e ka ndarë në disa pika.

Në pikën 1 te ankesës AKR kërkon që të rinumërohen të gjitha vendvotimet pasi që siç thuhet nga rinumërimi i 439 vendvotimeve nga ana e QNR-së në 421 vendvotime është konstatuar keqpërdorimi i vullnetit të votuesve andaj mbi bazën e këtyre informatave AKR kërkon rinumërimin e të gjitha vendvotimeve.

Në pikën 2 të ankesës subjekti politik AKR kërkon rinumërimin dhe hetimin e këtyre vendvotimeve pasi që dyshohet se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja dhe FPR-ve dhe FRK-ve për këto vendvotime si në vijim; Klinë 0805C/03R; 0801C/08R; 0817C/01R; Vushtri 2702X/01R; 2702X/03R; 2713B/03R Lipjan 1304E/01R; 1325E/01R Prishtinë 1921E/05R; 1912E/03E; 1907E/02D Ferizaj 2505D/02R; Gjilan 0407D/01R

Në pikën 3 të ankesës së saj AKR kërkon që të anulohen të gjitha votat e ardhura me postë pasi që siç thuhet KQZ nuk ka arritur standarde të votimit me postë dhe se këtë e vërtetojnë edhe votuesit nga Serbia të cilët kanë bërë ankesa në gjykata lidhur me atë se në emër të tyre dikush tjetër ka votuar.

Në pikën 4 subjekti politik AKR kërkon nga PZAP që të hetohen votat e shpallura si të pavlefshme vetëm në ato vendvotime ku ka më shumë se 10 fletëvotime të pavlefshme.

Në nenin 117.2 te LZP-së është paraparë “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”, andaj në bazë të kësaj dispozite juridike, PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit te ankesës dhe provave te administruara, gjeti se:

- ankesa është pjesërisht e bazuar

Sa i përket pretendimeve ankimore si në pikën dy të ankesës PZAP-i, gjene te njëjtat janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit te provave dhe shkresave te lendes, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve te shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara nga vete ankuesi, andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së PZAP-i urdhëron që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për këto vendvotime si në vijim; Klinë 0805C/03R; 0801C/08R; 0817C/01R; Vushtri 2702X/01R; 2702X/03R; 2713B/03R Lipjan 1304E/01R; 1325E/01R Prishtinë 1921E/05R; 1912E/03E; 1907E/02D Ferizaj 2505D/02R; Gjilan 0407D/01R, dhe që ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2014.

Ndërsa lidhur me pretendimet tjera ankimore te paraqitura ne pikat I, III dhe IV të ankesës në fjalë PZAP-i konsideron se te njëjtat janë të **pabazuara**, pasi që nuk ka prova të besueshme që vejnë në dyshim numërimin e te gjitha fletëvotimeve ne vendvotimet në Kosovë. Po ashtu ne ankesë nuk janë dhënë prova dhe fakte te pakontestueshme për anulimin e te gjitha votave te ardhura me postë. Aq me tepër rezulton se është i pabazuar pretendimi ankimor që të hetohen votat e shpallura si të pavlefshme vetëm në ato vendvotime ku ka më shumë se 10 fletëvotime të pavlefshme, pasi që ne ankesë nuk janë dhënë arsye faktike dhe juridike te pranueshme për hetimin e këtyre votave.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 409/2014 më datën 30.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.